



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

KRYETARI

Nr. 2685 Prot

Roskovec, më 12.6.2020

VENDIM

Nr. 15 datë 12.06.2020

**“PËR ZHVENDOSJEN E FAMILJEVE PËRKATËSE NË ZBATIM TË
PROJEKTIT “PËR RIKUALIFIKIM URBAN DHE ZHVILLIMIN E BLOKUT
NR. 2 QENDRA E QYTETIT ROSKOVEC”**

Në mbështetje dhe ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” ; të Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë neni 190; të Ligjit nr.8561 date 22.12.1999 “Per shpronësimet dhe marrjen në përdorim të perkohshëm të pasurisë prone private për interes publik” neni 8 , germa Ç, neni 10 i tij ; të Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.127 date 23.03.2000 “Per përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të perkohshëm të pasurisë prone private për interes publik”; të Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr.872 date 12.12.2007 ; të Aktit Normativ nr. 6 datë 6.11.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar” ; të Marreveshjes së Investimit nr. 3562/1 prot.date 14.09.2018 nënshkruar midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Roskovec për këtë projekt, Oponenca teknike e Institutit të Ndertimeve, për këtë projekt, depozituar në institucionin tone me date 18.09.2018; të Vendimit të Keshillit Bashkiak nr.35 date 13.06.2016 për miratimin e „Rehabilitimi urban i tre blloqeve në Bashkinë Roskovec“, konfirmuar ky vendim mbi ligjshmerinë e tij me shkresë nr.573/1 prot.date 24.06.2016 nga Prefekti i Qarkut Fier; të Vendimit të Keshillit Bashkiak nr.68 date 26.09.2017 “Per rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr.2 Qendra e qytetit Roskovec” konfirmuar ky vendim mbi ligjshmerinë nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr 1013/1 prot.date 10.10.2017; të Vendim i Keshillit Bashkiak nr.76 date 18.10.2018

“Per miratimin e investimit per ndertimin e nje godine 3 kateshe per strehim social” të Vendim i Keshillit Bashkiak nr.84 date 18.10.2018 “Per pagesen e qerases per familjet ne nevoje”; të Relacionit nr.2578 prot.datë 09.06.2020 të Komisionit për kryerjen e procedurave të zhvendosjes krijuar me Urdhërin nr.49 datë 08.05.2020 si dhe të relacionit nr.2332 prot.datë 07.05.2020 të grupit të punës për shitjen e pronave publike krijuar me urdhër nr.48 datë 08.05.2020 “,

KONSTATOVA SE:

Këshilli i Bashkisë Roskovec me vendim nr. 27, datë 27.04.2020 „Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të bashkisë Roskovec, për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe përjashtimit nga procesi i legalizimit“ ka vendosur strehim alternativ nëpërmjet shitjes së apartamenteve në pronësi të Bashkisë Roskovec për 3 (tre) familjet të cilat kanë rezultuar të pastreha si rezultat i zbatimit të projektit për interes publik "Rikualifikimi urban dhe zhvillimor i bllokut nr.2 , qendra e qytetit Roskovec", banesat e të cilëve prishen për shkak të interesit publik dhe që nuk shpronësohen, konkretisht familjet banore të bashkisë Roskovec , me kryefamiljar:
1-Shkëlqim Begaj , 2-Naxhie Driza , 3-Fatmir Kasëmaj.

Për zbatimin e këtij Vendimi të Këshillit Bashkiak, më datë 08.05.2020 janë krijuar dy grupet e punës si më :

- Urdhërin e brendshëm nr.48 “Për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e procedurave ligjore për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të bashkisë Roskovec, për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe përjashtimit nga procesi i legalizimit”,
- Urdhërin e brendshëm nr.49 “Për ngritjen e grupit të punës për zhvendosjen e familjeve nga banesa aktuale”.

Sipas relacionit nr.2332 prot.datë 27.05.2020 të grupit të punës të shitjes së pronave në pronësi të bashkisë Roskovec është caktuar cmimi respektivisht për 3 (tre) apartamente , për këto 3 (tre) familje.

Sipas relacionit të komisionit të kryerjes së procedurës së zhvendosjes nga banesat aktuale të këtyre 3 (tre) familjeve , është kryer procedura e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 361, datë 29.05.2019 „Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional“ .

Rrjedhimisht janë njoftuar të treja familjet dhe rezulton se :

- **Familja e z.Fatmir Kasëmaj** , është paraqitur brenda afatit të caktuar dhe ka zhvilluar takim me komisionin e zhvendosjes , për zhvendosjen e kësaj familjeje në godinën/pronën publike të caktuar nga bashkia për strehim alternativ.Sipas procesverbalit të takimit rezulton se kjo familje ka shprehur dakortësinë për tu zhvendosur në njërin prej apartamenteve të caktuara nga Bashkia Roskovec.
- **Familja e znj.Naxhie Driza** ka marrë dijeni për njoftimin dhe brenda afatit të caktuar (edhe pse i është dërguar rinjoftim sipas Kodit të Procedurave Administrative) rezulton se **nuk është paraqitur** për takim e për tu dërguar nga ana jonë në lidhje me pretendimet që mund të kishte.
- **Familja e z.Shkëlqim Begaj** nuk është njohur me njoftimin e parë të bashkisë pasi sipas shënimit të postës shqiptare rezulton „*Larguar jashtë shtetit*“. Njoftimi ka vijuar sipas nenit 160 të Kodit të Procedurave Administrative duke ia dërguar njoftimit një të afërmi të kësaj familjeje, më pas një fqinji të cilët të dy këta të fundit nuk kanë pranuar ta marrin në dorëzim njoftimin për takim për familjen e z.Shkëlqim Begaj.Rrjedhimisht duke qenë se kjo familje ndodhet jashtë shtetit shqiptar dhe rezulton se ansjë prej anëtarëve të kësaj familjeje nuk është i punësuar në shtetin shqiptar , pra nuk ka një vend pune të caktuar për t’ia dërguar njoftimin për takim për zhvendosje, më datë 04.06.2020 ky njoftim është afishuar në këndin e publikimeve të bashkisë Roskovec.Në këtë datë të sotme ndodhemi brenda afatit të caktuar sipas të cilit ky njoftim duhet të qëndrojë i afishuar deri më datë 14.06.2020.

Rezulton se me shkresat nr.2188 prot.datë 14.05.2020 dhe nr.2187 prot.datë 14.05.2020 për procedurën e zhvendosjes janë njoftuar edhe institucionet përkatëse konkretisht Prefekti i Qarkut Fier, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Avokati i Popullit.

Për sa më sipër , në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 361, datë 29.05.2019 „Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj dhe të bashkëpunimit institucional“ pika 8.1 e tij,

VENDOSA:

1. **Zhvendosjen e familjeve z.Fatmir Kasëmaj dhe znj.Naxhie Driza** nga banesat aktuale , në banesat e përcaktuara nga bashkia Roskovec për strehim alternativ.
2. Ngarkohet për ekzekutimin e këtij vendimi duke respektuar pikat 9.3, 9.4, 9.5, 9.6, 9.7, 9.8, 9.9, 12.2, 12.4 të VKM nr. nr. 361, datë 29.05.2019 „Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional“ pika 8.1 e tij, **grupi i punës** si më poshtë:
 - 1.Ysen Agaci - “Zëvendëskryetar”
 - 2.Eldison Kocaqi - “Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Pronave”
 - 3.Brunilda Hajdini - “Shef Sektori i Policisë Bashkiake”
 - 4.Sokol Prifti - “Polic Bashkiak”
 - 5 Edlira Toro - “Përgjegjëse e Sektorit të Financës”
3. Për cdo zhvendosje grupi i punës të mbajë procesverbal identifikimi të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.
4. **Afati i ekzekutimit të këtij vendimi është data 28.06.2020 , orari 08:00 – 17:00.** Nuk lejohet ekzekutimi i këtij vendimi në mot jo të favorshëm.Nëse do të rezultojë mot jo i favorshëm atëherë me një tjetër akt amdinistrativ do të caktohet afati i ekzekutimit të zhvendosjes së këtyre dy familjeve.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë dy kryefamiljarëve të këtyre dy familjeve si dhe Policisë Bashkiake, Policisë së Shtetit dhe Prefektit të Qarkut Fier.

6. Subjektet të cilët preken nga ky vendim kanë të drejtën e ankimit ne Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga njohja me të.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
8. Ngarkohet Sekretari-Arkivi për kryerjen e njoftimeve përkatëse.
9. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Zëvendëskryetari z.Maksim Goga.

Konceptoi.E.Gishto

Sasia e ekzemplarëve të shtypur : 2 (dy)



KRYETAR
Majlinda Bufi

